



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

Datë:15/07/2021

Ref: 720/2021

RAPORT

implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :

- Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore përmes realizimit të programeve trajtuese psiko sociale të dhunuesve/abuzuesve,
- Ofrimin e këshillimeve psikologjike përmes telefonit për të gjitha kategoritë në nevojë që kanë shqetësime emocionale dhe psikologjike sidomos nën efektin e situatës së pandemisë COVID 19.

I. Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht Objektivit Strategjik 3: *Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore, synon të adresoi çështjet e ofrimit:*

- I. Të shërbimeve psiko sociale/ trajtimit për kryesit e dhunës
- II. Të asistencës psiko-sociale përmes shërbimeve telefonike falas, si përgjigje ndaj shqetësimeve psikologjike-emocionale gjatë periudhës së COVID 19.

Në këtë thirrje publike kanë aplikuar gjithsej 14 Organizata Jo Qeveritare të cilat kanë paraqitur projektet e tyre nga fusha e thirrjes publike. Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendim marrjes në përputhje me kriteret e rregullores për financimin publik të OJQ-ve. Në vijim të këtij raporti janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhënat sa i përket thirrjes publike, organizatave që kanë aplikuar, dhe organizatave dhe projekteve përfituese

II. Qëllimi i thirrjes publike

Agjencia për Barazi gjinore, ka bërë thirrje të gjitha organizatave jo qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës mandati i të cilave është i fokusuar dhe profilizuar në fushën e trajtimit dhe këshillimit psiko-social që të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në:

- Parandalim të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave përmes trajtimit të kryerësve të dhunës, përmes trajtimit të specializuar profesional psikologjik
- Funksionimin e qëndrueshëm të linjave telefonike falas të këshillimit psiko-social,

Thirrja është implementuar në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJ

III. Objektivi i përgjithshëm i kësaj thirrje është zbatimi i drejtpërdrejtë i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht Objektivit Strategjik 3: *Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore, synon të adresoi çështjet e ofrimit*

Ndërsa, fushat specifike të kësaj Thirrje për Propozime janë :

- Trajtim i kryerësve të dhunës** – Përkrahja e projekteve në këtë fushë ka për qëllim parandalimin e akteve të tjera të dhunës, me qëllim që të ndalet cikli i dhunës me bazë në gjini dhe dhunës në familje. ABGJ mund të përkrahë organizatat me përvojë të dëshmuar me **programe specifike** në këtë fushë në aktivitete të ndryshme relevante, duke përfshirë si në vijim:
 - a. Trajtim psiko-social për kryesit e dhunës përmes seancave individuale dhe në grup,
 - b. Programe profesionale të targetuara vetëm për këtë kategori, duke inkurajuar djemtë dhe burrat për të kërkuar ndihmë
- Linjë për këshillim psikologjik falas** – Kjo linjë telefonike do të shërbejë për të gjithë ata që kanë nevojë për këshilla në mënyrë që të kujdesen për shëndetin e tyre mental. Në kuadër të kësaj linje mund të pranohen thirrje nga persona që kanë probleme emocionale në formë të tilla si ankthi, trishtimi, ndjesinë e vetmisë, ndjeshmëri të lartë, depresioni, konsiderojnë vetëvrasjen, etj, të cilat në veçanti janë theksuar si pasojë e pandemisë COVID 19. Linja duhet të mundësohet ndaj të gjitha kategorive, duke përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës në familje, ata që kanë humbur anëtarë të familjes nga COVID-19 apo arsye të tjera shëndetësore humbjen e punës, ngacmimi seksual apo faktorë të tjerë dhe rrethana të tjera që cenojnë shëndetin e psiko-emocional.

Ky shërbim do të kontribuoj edhe në luftimin e stigmës për problemet e shëndetit mendor dhe të ofrojë informacion referues për ndihmë mjekësore dhe profesionale në se informacioni kërkohet nga individët Të gjitha aktivitetet e propozuara duhet të jenë konkrete dhe të realizueshme brenda afateve kohore. Në kuadër të aktiviteteve të propozuara, aplikuesit duhet të specifikojnë metodologjinë që do të përdorin për aktivitete, si dhe mënyrën se si do të sigurojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të personave që marrin shërbime në të dy fushat.

Prandaj , OJQ-te kishin mundësinë të aplikojnë me projektet e tyre për fushat prioritare të lartpërmendura

I. Informata mbi OJQ-te aplikuese dhe përfituesit

Ne kuadër të kësaj thirrje publike kanë aplikuar gjithsej 14 organizata jo Qeveritare me gjithsej 14 projekte. Ne vijim është paraqitur lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike.

1. Shtëpia e Sigurt – Erblina Rama
2. Qendra për Informim dhe përmirësim Social- Linja e Jetës – Bind Skeja
3. Progresi për Avancim Rinor PARKS- Gentiana Ukshini
4. Okarina e Runikut- Fetije Smakaj
5. Uraz- Ramsela Saiti
6. Qendra për shërbime humane dhe zhvillim- Mimoza Shahini
7. Organizata për zhvillim Llogaritari - Florentina Millaku
8. OJQ Dita - Aferdita Zeneli
9. OJQ SIT Qendra për këshillim shërbime sociale dhe hulumtime – Kadri Gashi
10. OJQ Për mendje të shëndoshë – Xhemajl Berisha
11. Shoqata e personave me paralizë të fëmijëve Handikap – Egzona Hoxhaj
12. Femrat Aktive të Gjakovës – Valbonë Doli Rizvanolli
13. OJQ lidhja e Artë – Arta Zeneli
14. Shoqata e psikologëve Malishevë – Eshref Zogaj

Prej gjithsejtë 14 aplikacioneve, 3 prej tyre i kanë plotësuar kushtet për financim

II. Vlerësimi dhe publikimi i rezultateve

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar komisionin vlerësues, i cili kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike. Komisioni përbehej nga 3 zyrtar të ABGJ-se dhe dy përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht eksperte të jashtëm. Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet nga aspekti procedural dhe ato që kanë plotësuar kriteret edhe nga aspekti përmbajtësor i projekt propozimeve. Nga gjithsej 14 OJQ aplikuese, prej tyre 8 i kanë plotësuar kriteret procedurale dhe projektet e tyre janë vlerësuar sipas kriterëve të rregullores për financimin publik të OJQ-ve, ndërsa 6 tjetra në mungesë të dokumenteve relevante, dhe fushave specifike të kërkuara në thirrje janë diskualifikuar . Ndër hapat kyç; në procesin e vlerësimit të projekt

propozimeve bëjnë pjesë:

- Janë vlerësuar aplikacionet nëse i plotësojnë kriteret procedurale;
- Janë vlerësuar projekt propozimet e OJQ-ve që i kanë plotësuar kriteret procedurale;
- Vlerësimi është bërë në formularët e paraparë sipas rregullores MF-Nr. 04/2017 dhe manualit për zbatimin e saj nga secili anëtar komisioni;
- Është bërë kalkulimi i pikëve për secilin projekt propozim dhe është bërë radhitja e projekteve sipas pikëve të fituara;

Agjencia për Barazi Gjinore me hapjen e kësaj thinje publike ka treguar një shembull pozitiv në zbatimin e rregullores për financimin publik të OJQ-ve, duke respektuar të gjitha kërkesat, duke përfshirë hapjen e një thirrjeje transparente në themelimin e një komisioni për vlerësim transparent të aplikimeve me përfaqësues edhe nga shoqëria civile, publikimin e rezultateve paraprahe dhe përfundimtare deri në këtë fazë kur duhet të përmbyllet me nënshkrimin e kontratave dhe monitorimin e implementimit të projekteve.

Lista preliminare e përfutuesve të OJQ-ve

Nr.	Emri i OJQ	Emri i Projektit	Totali i Përvës
I.	Qendra për Informim dhe përmirësim Social- Linja e Jetës	Linja e Jetës	77.8
II.	OJQ SIT Qendra për këshillim shërbime sociale dhe hulumtime	Këshillim për parandalim	74.2
III.	Shtëpia e Sigurt	Parandalimi I dhunës ne familje dhe dhunës ndaj gruas përmes trajtimit psikosocial te kryerësve te dhunës	64.2

Ne tabelën ne vijim janë paraqitur piket sipas kritereve te vlerësimit, duke përfshirë piket qe kanë marrë secila OJQ dhe projektet aplikuese, si dhe të gjitha ato OJQ te cilat nuk janë vlerësuar në mungesë te dokumenteve relevante, dhe fushave specifike të kërkuara ne thirrje janë diskualifikuar.

Sipas rregullores së MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ afati për paraqitje të ankesave është pesë (5) ditë pune nga data 16 deri me 23 korrik 2021 në ora 16:00, ankesat duhet të dorëzohen në kopje fizike, Në Agjencinë për Barazi Gjinore/ZKM kati VII-zyra 711.

Komisioni Vlerësues i kësaj thirrje ishte në përbërje :

1. Shpresa Zariqi – Kryesuese e komisionit
2. Leonora Selmani – Anëtare
3. Yllka Kotorri – Anëtare
4. Yllka Buzhala – Anëtare
5. Sebahate Grajçevci – Anëtare



Me respekt,